



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:098795
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05525061

Ac.nr.6650/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti – kryetare e kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Besnik Feka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Z., nga fshati Z....., Komuna Klinë, të cilin e përfaqëson me autorizim G.M., avokat nga Klina, kundër të paditurit M.P.S., nga fshati Z....., tani me adresë të panjohur, për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, C.nr.250/2021, të datës 12.07.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit A.Z., nga fshati Z....., Komuna Klinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, C.nr.250/2021, i datës 12.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, C.nr.250/2021, të datës 12.07.2023, ka vendosur si vijon:

‘KONSIDEROHET se është tërhequr padia e paditësit A.Z., nga fshati Z....., Komuna Klinë, të cilin e përfaqëson G.M., avokat nga Klina, kundër të paditurit M.P.S., nga fshati Z....., tani me adresë të panjohur, me objekt të padisë, vërtetim pronësie.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të mos përfilljes së rrethanave të cilat do të shkonin në favor të palës, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktvendimi ankimor të anulohet dhe të pranohet propozimi i paditësit lidhur me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin i cili është me adresë të panjohur.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se :

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar padi me datë 24.05.2021, kundër të paditurit M.P.S., nga fshati Zajm, tani me adresë të panjohur, për vërtetim pronësie.

Gjykata me aktvendimin C.nr.250/21 të dt.25.05.2022, e ka detyruar paditësin që në afatin e caktuar të siguroj adresën e saktë për të paditurin pasi që adresa e dhënë në padi nuk është e plotë. Me parashtrësën e dt.30.05.2022 paditësi i ka propozuar gjykatës duke qenë se të paditurit nuk i dihet adresa, konform nenit 79.1 dhe 79.3 të LPK-së, të paditurit M.P.S., të cilit nuk i dihet adresa, t'ia caktoj përfaqësuesin e përkohshëm nga radhët e avokatëve të OAK-së.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të paditësit, pasi që ka ndërmarrë veprimet e nevojshme duke shteruar mjetet për sigurimin e adresës së saktë për të paditurin, i është drejtuar Odës së Avokatëve të Kosovës që të caktoj një avokat për të paditurin konform nenit 81.1 të LPK-së, me qëllim që ti përfaqësoj interesat e të paditurit në këtë çështje kontestimore. Tutje Gjykata pasi që ka marrë konfirmimin nga OAK, e cila ka caktuar një avokat sipas radhës, me aktvendimin e datës 06.06.2023, e ka obliguar paditësin që në emër të paradhënies për shpenzimet që do të krijoheshin lidhur me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, për të paditurin, brenda afatit të caktuar, të deponoj në arkën e gjykatës shumën në lartësi prej 1,000.00 euro, nën kërcënimin e pasojave të lëshimit.

Duke qenë se paditësi edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga gjykata dhe nga dita e nxjerrjes së aktvendimit mbi caktimin e paradhënies, dhe marrjes në dorëzim nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, nuk ka vepruar konform tij, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin C.nr.250/21 të dt.12.07.2023, me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit ankimor.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ka theksuar se gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore dhe më pastaj e ka obliguar propozuesin në deponimin e shumës për garancinë, si kusht që të vendoset masa e sigurimit, mirëpo nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi ka kaluar afati kohor brenda të cilit paditësi, përkatësisht i autorizuari i tij, ka qenë i obliguar që të veprojë, ndërsa që nga shkresat e lëndës nuk kanë ekzistuar prova që të jetë

vepruar sipas vendimit të gjykatës, respektivisht se paditësi ka deponuar shumën e garancisë së kërkuar në llogarinë e KGJK-së. Për mënyrën e vendosjes si në aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 297 par.3 dhe 306 par.3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me dispozitën e nenit 81, paragrafi 1, të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se: *“Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve”*, ndërsa me paragrafin 2, të të njëjtit nen është përcaktuar se: *‘Në rastet nga paragrafi 2 i nenit 79 të këtij ligji i padituri ka për detyrë të deponoj shumën e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjtit nen shpenzimet i deponon paditësi’*.

Meqenëse, aktvendimi ankimor përmban dispozitiv të kuptueshëm, ndërsa në arsyetim janë paraqit arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet të cilat kanë qenë me rëndësi për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore, për këtë arsye thëniet e paditësit lidhur me atë se aktvendimi ankimor është rrjedhojë e shkeljeve qenësore nga dispozitat e nenit 182 par.1 dhe 182 par.2, pika n) të LPK-së, janë të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit ankimor, për faktin se nga provat në shkresat e lëndës nuk kanë ekzistuar prova që do të vërtetonin se paditësi ka vepruar sipas aktvendimit të gjykatës mbi deponimin e shumës së garancisë, ashtu siç e ka caktuar në llogarinë e KGJK-së edhe pse ka kaluar afati brenda të cilit paditësi ka pasur obligim që të veprojë. Gjykata e shkallës së parë ka ndërmarë veprimet procedurale ashtu siç i ka propozuar paditësi, ndërsa nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se në këtë çështje gjykata ka pasur për obligim që të caktoj përfaqësuesin e përkohshëm, i cili e përfaqëson familjarin e tij në një lëndë tjetër, sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate, ata kanë pasur mundësi që në një padi të vetme të përfshihen nëse çështja ka të bëjë me të njëjtin objekt të çështjes dhe me të njëjtin subjekt të padisë, në mënyrë që të kursen prej shpenzimeve të procedurës që kërkohet sipas dispozitave ligjore në rastet kur të paditurit nuk i dihet adresa, ndaj në situatë të tillë gjykata nuk mund ta liroj paditësin nga ky detyrim, sepse padia është veprim disponibil, por që propozimet pastaj kanë pasojë ligjore të cilat duhet t'i bartin palët të cilat i kanë propozuar ato, siç përcaktohet me dispozitat ligjore të LPK-së.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6650/2023, me datë 21.03.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.

Numri i lëndës: 2021:098795
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05525061